



VENDIM

Nr. 47 Datë 03.05.2013

MBI

**PROJEKTET PRIORITARE NE RRJETIN E SHPERNDARJES
PËR VITIN 2013**

Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", të ndryshuar, nenit 14 të Rregullores për emërimin e administratorit dhe kompetencat e tij, miratuar me Vendimin nr. 1, datë 10.01.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERE, , në mbledhjen e datës 03.05.2013, Bordi i Komisionerëve të ERE-s pasi shqyrtoi relacionin e përparuar nga grupi i punës,

Pasi Konstatoi:

- Statusin juridik të shoqërisë CEZ Shpërndarje të vendur në administrim të përkohshëm sipas nenit 18, pikë 4, germa c, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar;
- Rekomandimin e Avokates e Shtetit mbi kompetencat e administratorit të përkohshëm të shoqërisë CEZ Shpërndarje, dërguar me shkresën nr. 1705/41, datë 08.02.2013;
- Rekomandimet e grupit të punës mbi projektet që duhet të zbatohen nga ana e shoqërisë CEZ Shpërndarje;

Vendosi:

1. Miratimin e projekteve prioritare në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2013, të domosdoshme për operimin e sigurtë të rrjetit të shpërndarjes dhe sigurimin e furnizimit të pandërprerë me energji elektrike të konsumatorëve, me vlerë monetare 1.087.892.629 Lekë, sipas relacionit të grupit të punës.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol RAMADANI